



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2901 Prot.

D. 21.05.2019

V E N D I M

Nr. 48, date 17/05 / 2019

“PER MIRATIMIN E PROJEKTIT “BUZEQESHJA SHUMENGJYRSHE E FEMIJEVE”

Ne mbeshtetje te ligjit 139/2015 “Per veteqeverisjen vendore“, Ligjit nr.9936 date 26.06.2008 “Per menaxhimin e sistemit buxhetore ne RSH” I ndryshuar, te ligjit 68/2017 “Per financat e veteqeverisjen vendore“, te udhezimit te Ministrise se Financave nr.9 date 20.03.2018 “Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit”, VKB nr.104 date 19.12.2018 “Per miratimin e buxhetit dhe numrin maksimal te punonjesve te Bashkise Roskovec per vitin 2019” ,si dhe materjaleve te sjelle nga sektori i menaxhimit te projekteve sociale , keshilli i bashkise :

Vendosi:

1. Miratimin e projektit “Buzeqeshja shumengjyrshe e femijeve” , ne kuader te projektit “Siguria Publike në Nivel Vendor” , projekt i financuar nga Fondacioni per Qeverisjen dhe Autonomi Lokale (Foundation for Local Autonomy and Governance (FLAG)).
2. Vlera e projektit eshte 810,000 leke i financuar nga Fondacioni per Qeverisjen dhe Autonomi Lokale ((Foundation for Local Autonomy and Governance (FLAG)).
3. Ngarkohet ekzekutivi i bashkise per zbatimin e ketij vendimi dhe per vazhdimin e procedura te metejshme te menaxhimit te ketij projekti.

Shtohet: Gr.00 Tit.01110 Kap.05 Art.231 **810,000 leke**

KRYETAR

Eleni GOGA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2902 Prot.

Roskovec, me 20, 05 2019

VENDIM

NR. 49. DATE 17. 05. 2019


“PËR LIDHJEN E MARRËVESHJES SË BASHKËPUNIMIT “MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË ROSKOVEC”

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, neni 24 pika 2 dhe 3; Ligjit Nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, Keshilli i Bashkisë,

VENDOSI :

- 1- Miratimin e lidhjes se Marrëveshjes se bashkëpunimit me Entin Kombëtar të Banesave për bashkëfinancimin e një objekti social dhe shërbimesh 6 katësh, për tu përdorur sipas programeve sociale të strehimit.
- 2- Autorizimin e Kryetarit të Bashkisë Roskovec për nënshkrimin e Marrëveshjes së Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për banesat me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”.
- 3- Pjesë përbërëse e Vendimit është Draftmarrëveshja e Bashkëpunimit “Mbi zbatimin e programit për banesat me kosto të ulët në Bashkinë Roskovec”.

KRYETAR
Eleni Goga





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nr _____ Prot
____ / ____ / 2019

Nr _____ Prot
____ / ____ / 2019

ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

BASHKIA ROSKOVEC

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT PËR BANESAT ME KOSTO TË ULËT NË BASHKINË ROSKOVEC

Mbështetur në Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr.22/2018 “Për Strehimin Social”, si dhe në përputhje me Vendimin Nr.198 datë 4.05.1993 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Entit Kombëtar të Banesave”, i ndryshuar:

Lidhet kjo marrëveshje bashkëpunimi, ndërmjet palëve:

- **Enti Kombëtar i Banesave**, përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Z. Stefan Çipa;
dhe
- **Bashkia Roskovec**, përfaqësuar nga Kryetari i Bashkisë, Z. Majlinda Bufi.

Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

1. Qëllimi i marrëveshjes është të përcaktojë angazhimin e ndërsjellë të Entit Kombëtar të Banesave dhe të Bashkisë Roskovec, për një bashkëpunim dypalësh në funksion të përcaktimit të fushave, masave dhe mënyrave të bashkëpunimit, si dhe të sigurimit të mbështetjes së nevojshme institucionale nëpërmjet zbatimit të legjislacionit të fuqi me pikësynimin për:

a) të kontribuar në përmbushjen e objektivave të Qeverisë për politikën sociale të strehimit, si një nga prioritetet e saj;

- b) të adresuar problemet e strehimit për shtresat të cilat nuk mund të përballojnë dot çmimet e banesave në tregun e lirë;
- c) të realizuar ndërtimin e një banese me kosto të ulët;
- d) të miratuar në parim, vazhdimin e bashkëpunimit në fushën e strehimit, duke eksploruar bashkërisht forma e rrugë të tjera ligjore.

Neni 2

Objekti i marrëveshjes

1. Objekt i akt-marrëveshjes është financimi dhe ndërtimi gjatë viteve 2019-2022, i objektit të banim + shërbim, me 4 kate ambiente banimi me 32 apartamente dhe 2 kate ambiente shërbimi.
2. Financimi i objektit do të realizohet me bashkëfinancim nga të ardhurat e Bashkisë Roskovec për 2 kate shërbim dhe të ardhurat e Entit Kombëtar të Banesave për 4 kate banim sipas kostos.
3. Objekti i banimit klasifikohet në programin e banesave me kosto të ulët dhe do të shërbejë për strehimin e familjeve që kanë aplikuar pranë Bashkisë Roskovec për të përfituar një nga programet sociale të strehimit.

Neni 3

Angazhimet, detyrimet dhe përgjegjësitë e palëve

1. Palët e kësaj marrëveshje angazhohen:
 - Të bashkëpunojnë me vullnet të lirë dhe në mënyrë konstruktive në drejtim përmbushjes së qëllimit të kësaj marrëveshje, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi;
 - Në çdo rast, kur është e mundur, të publikojnë vlerat dhe kontributet e njëra-tjetrës në këtë projekt të përbashkët.
2. Enti Kombëtar i Banesave, si palë e kësaj marrëveshje, merr përsipër:
 - a) të realizojë financimin për 4 kate banim sipas kostos;
 - b) të vendosë në dispozicion të Bashkisë Roskovec të dhënat teknike-ekonomike të banesës (struktrat, sipërfaqet, çmimet e apartamenteve, etj), si dhe kritere të tjera paraprake që konsiderohen të domosdoshme nga EKB (psh. minimumin e të ardhurave që duhet të ketë familja përfituese, etj) , në funksion të përzgjedhjes, hartimit dhe miratimit të listave të familjeve përfituese nëpërmjet Këshillit Bashkiak.
3. Bashkia Roskovec, si palë e kësaj marrëveshje merr përsipër:
 - a) Të vërë në dispozicion të projektit:
 - truallin ku do të ndërtohet objekti i banimit, sipas planeve studimore që disponon bashkia Roskovec.
 - dokumentacionin tekniko-ligjor (çertifikatën për vërtetim pronësie, etj..) që disponohet për truallin ku do të ndërtohet;

- b) të vërë në dispozicion të EKB-së lejen përkatëse të zhvillimit brenda afatit ligjor, për ndërtimin e objektit të banimit me 4 kate ambiente banimi dhe 2 kate ambiente shërbimi, të pajisur me studim, nga momenti i aplikimit online, në Bashkinë përkatëse;
- c) të eliminojë pagesën e taksës mbi infrastrukturën;
- d) të investojë për sistemimin dhe infrastrukturën e zonës, duke përfshirë edhe rrjetin inxhinierik;
- e) të sigurojë brenda një afati 3 (tre) muajor nga data e njoftimit/kërkesës nga Enti Kombëtar i Banesave për (*referuar nenit 73, pika 2/a të Ligjit Nr.22/2018*), sipas kritereve të negociuara mes palëve, listën e familjeve përfituese të këtij programi, të miratuar nga Këshilli Bashkiak Roskovec ku të jenë specifikuar për çdo familje: pallati, kati, numri i apartamentit, struktura, sipërfaqja respektive dhe statusi i familjes nëse ka në përbërje persona PAK.
- f) të realizojë financimin 2 kate shërbim sipas kostos: projektimi, ndërtimi, mbikqyrja, kolaudimi dhe regjistrimi i pasurisë në bashkepronësi të Entit Kombëtar të Banesave dhe Bashkisë Roskovec;

4. Palët bien dakord që:

- a) Ndarja e apartamenteve të banimit, për familjet që do të përfitojnë strehim nga ky investim, do të bëhet me vendim të Këshillit Bashkiak Roskovec, sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave, konform legjislacionit në fuqi.
- b) Mënyra e shpërndarjes së banesave do të realizohet duke zbatuar një nga mënyrat e miratuara me Vendimin e Këshillit Drejtues të Entit Kombëtar të Banesave, mbështetur në legjislacionin në fuqi.

Neni 4

Vlefshmëria dhe zbatimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 3 (tre) vjeçare nga momenti i nënshkrimit të saj nga palët. Vlefshmëria e marrëveshjes mund të zgjatet me mirëkuptimin dhe vullnetin e palëve, kur këta të fundit nuk i kanë përmbushur detyrimet e tyre në kohë. Marrëveshja mund të rishikohet dhe të ndryshojë vetëm me shkrim dhe me nënshkrimin e të dy palëve.

Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve mes tyre me negociata direkte dhe me mirëkuptim. Në rast të kundërt, mosmarrëveshjet të zgjidhen sipas procedurave juridike në fuqi, bazuar në legjislacionin e Republikës së Shqipërisë;

Neni 5

Bashkërendimi i marrëveshjes

Palët bien dakord të përcaktojnë një/disa përfaqësues si pikë kontakti për secilën palë me qëllim bashkërendimin e punës në praktikë. Këta përfaqësues do të kenë kontakte direkte me institucionet respektive.

Pikat e kontaktit duhet të mbajnë të informuar në çdo kohë titullarin e palës përkatëse mbi ecurinë e zbatimit të marrëveshjes.

Neni 6

Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hartohet në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe:
- dy kopje për Drejtorinë e Përgjithshme të Entit Kombëtar të Banesave;
- dy kopje për Bashkinë Roskovec.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi pasi të jetë miratuar paraprakisht me vendimarrje nga Këshilli Drejtues i EKB-së dhe nga Këshilli Bashkiak i Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, si me pas me nënshkrimin e saj nga palët përkatëse (Drejtori i Përgjithshëm i EKB-së dhe Kryetari i Bashkisë).

Për Entin Kombëtar të Banesave

Stefan Çipa

Drejtori i Përgjithshëm

Për Bashkinë Roskovec

Malinda Bufi

Kryetar



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
KESHILLI BASHKIAK

Nr. 2903 Prot.

Roskovec, me 21.05 2019

VENDIM

NR 50 .DATE 17.05 .2019

**“PER DHENIEN E TITULLIT “QYTETAR NDERI” TE BASHKISE ROSKOVEC
Z.SABRI VLINGA,PAS VDEKJES”**

Mbështetur në Ligjin Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”, i ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9/1 pika 1/b dhe 7/a, neni 54 pika m, Ligji 112/2013 date 04.04.2013 “Per dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore te nderit ne Republikën e Shqiperise, neni 14, 15 pika 1/a dhe 16, Keshilli i Bashkise,

VENDOSI:

-Ti jape titullin “Qytetar Nderi” te Bashkise Roskovec **Z.Sabri Vlinga** pas vdekjes me motivacionin :

- ❖ “Per kontributin dhe perkushtimin e dhene me punen e tij si nje electricist i palodhur dhe i kudogjendur ne sherbim te komunitetit te Roskovecit, i cili humbi edhe jeten ne krye te detyres me 30.11.2017”

KRYETAR

Eleni Goga

